

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Sapuni i lëngshëm: duhet të ketë efekt shkumues të menjëhershëm dhe të sigurojë pastrim efikas të duarve, falë përqendrimit të përshtatshëm të tensioaktivit anionik dhe përbërësve të tjerë kimikë. Pas përdorimit, produkti duhet t'i lërë duart të hidratuara, falë pranisë së agjentëve emolientë. Për sa i përket përbërjes kimike, ai duhet të përmbajë lëndë aktive tensioaktive anionike jo më pak se 8% të vëllimit të produktit, tensioaktiv amfoter në masën 0.1% deri në 5% të vëllimit të produktit, si dhe alkool etilik ose izopropilik në masën 0.1% deri në 1% të vëllimit të produktit. Produkti duhet të përmbajë gjithashtu të paktën një përbërës emolient me bazë bimore dhe të paktën një përbërës konservues. Përmbajtja e joneve [H⁺] duhet të jetë në intervalin pH 5 deri në 8, ndërsa biodegradimi parësor duhet të jetë jo më pak se 80%. Jetëgjatësia e produktit duhet të jetë jo më pak se 12 muaj nga koha e lëvrimit. Paketimi duhet të jetë në bidonë plastike me vëllim nga 0.5 deri në 1 litër, të pajisur me mekanizëm, si dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

2. Solucion larës WC dezinfektues: Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%. Ambalazhimi në shishe plastike me kapacitet 750ml, me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të WC.

3. Fshesa merimangash me bisht të gjatë. Koka të jetë në formë bohçe me fije plastike polietilen ose ekuivalent me diametër të jashtëm 30-40cm. Gjatësia e fijeve 80-100 mm. Filetimi konik ose cilindrik me material polipropilen ose ekuivalent. Të ketë bisht teleskopik me 2 ose 3 hapje dhe me gjatësi 200-250 cm. Materiali i bishtit metal i plastifikuar ose duralumin. Fileto konike ose cilindrike prej material polipropilen ose ekuivalentin e tij dhe të përputhen filetot e bishtit me ato të kokës plastike në formë bohçe.

4. Fshesa pastrimi me fije të gjata pa bisht. Me fije të dendura dhe të buta. Me fileto për montimin e bishtit, material PVC. Bazamenti për mbajtjen e fijeve të pastrimit të jetë i gjerë 3-5 cm dhe me gjatësi 25

-30 cm. Materiali i fijes të jetë plastike PVC ose ekuivalent. Gjatësia e fijes 10-12 cm. Filetot e fshesës të përputhen me ato të bishtit të ofertuar.

5. Bishta të gjatë për fshesa dhe shtupa. Bishti të shërbejë për përdorim profesional dhe materiali i bishtit të jetë përbërë prej duaralumini ose metali të plastifikuar/me lysterje antikorrozive, në formë tubi me diametër 24-26 mm dhe spesor 1-1.5 mm. Fileto e bishtit të jetë konike ose cilindrike dhe të përputhet me filetimin e shtupës dhe të fshesës. Gjatësia e bishtit të jetë 130-140 cm. Filetot e bishtit të përputhen me ato të fshesës të ofertuar.

6. Fshesë pastrimi territori me melakuq të dendur. Duhet të jetë profesionale me fije të dendura dhe me bisht druri ose metali/duralumini me gjatësi 100 -120cm dhe diametër 22-25mm. Gjatësia totale me gjithë fshesë 140-160 cm. Bishti të jetë i kapur me fshesën, në mënyrë të fabrikuar. Gjatësia e fijeve të fshesës 40-50cm, gjerësia e hapjes së fijeve në fund të fshesës të jetë 35-45 cm me trashësi 5-8 cm.

7. Furçë pastrimi për WC me mbajtëse. Duhet të jetë profesionale me fibra sintetike në formë bohçe me diametër të jashtëm 6-10 cm, me bisht të gjatë 25-35 cm dhe e kompletuar me mbajtësen e furçës. Furça të jetë me kapak të inkorporuar që të përputhet plotësisht me mbajtësen e furçës. Mbajtësja e furçës të jetë e përbërë me material Polipropilen ose ekuivalent dhe të përputhet plotësisht me furçën dhe kapakun e saj.

8. Kaci për mbledhjen e mbeturinave. Kacia duhet të jetë për përdorim profesional me thellësi 10-15cm. Duhet të jetë material polipropilen ose ekuivalent me bisht metalik të plastifikuar ose duralumini 80-100 cm të gjatë. Tehu i kakisë të jetë me gjerësi 25-30 cm dhe gjatësi 30-35cm.

9. Solucion larës për mobiljet: Me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Pastrues neutral me pak shkumë. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5, ndërsa biodegradimi parësor duhet të jetë jo më pak se 80%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 7%. Ambalazhimi në shishe plastike 0.5 deri 1 litra sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

10. Kosha plastikë për hedhjen e mbeturinave (8-10 litra). Koshi i mbeturinave për përdorim të brendshëm duhet të jetë me volum 8-10 litra, me thellësi 35 ± 2cm, gjerësi 20 ± 2cm x 15 ± 2cm (pa përfshirë kapakun). Materiali të jetë Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku të jetë i çmontueshëm dhe të hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lëkundje pas derdhjes së mbeturinave.

11. Kosha plastikë për hedhjen e mbeturinave (25-28 litra). Koshi i mbeturinave për përdorim të brendshëm duhet të jetë me volum 25-28 litra, me thellësi 50±5 cm, gjatësi 30±2 cm x gjerësi 20±2 cm (pa përfshirë kapakun). Materiali të jetë Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku të jetë i çmontueshëm dhe të hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lëkundje pas derdhjes së mbeturinave.

12. Kosha plastikë për hedhjen e mbeturinave (50-60 litra). Koshi i mbeturinave për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm duhet të jetë me kapacitet 50-60 Litra, me thellësi 40 ± 5cm gjerësi 30 ± 5cm x

25 ± 5cm (pa përfshirë kapakun), materiali Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku të jetë i çmontueshëm dhe të hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lëkundje pas derdhjes së mbeturinave.

13. Kosha plastikë për hedhjen e mbeturinave me rrota. Koshi të ketë të montuara jo më pak se dy rrota me diametër 15-20cm. Duhet të jetë me kapacitet 120 ± 10 Litra, me dimensione 50 ± 10cm x 60 ± 10cm x 100 ± 10cm, material Polipropilen (PP). Kapaku të hapet me anët pedales që shtypet me këmbë dhe të lëvizë me anë të menteshave të kapura në trupin e koshit për hapje dhe mbyllje. Standartet Teknike që duhet të përmbushë, si vijon: Standartin Shqiptar SSH EN 840-6:2020 - Kazanët e lëvizshëm të mbeturinave - Pjesa 6: Kërkesat e shëndetit dhe të sigurisë, ose ekuivalentin e tij

14. Kovë pastrimi me shtrydhëse. Kova profesionale për pastrim/larje me mekanizëm për shtrydhëse ku mekanizmi i shtrydhjes të jetë i çmontueshëm lehtësisht. Kova duhet të jetë me volum 15 -18 litra, me thellësi 35 ± 5cm, gjerësi 30 ± 5cm x gjatësi 35 ± 5cm (pa përfshirë shtrydhësen). Të jetë e përbërë nga material Polipropilen ose ekuivalenti i tij, të ketë dorezë plastike për mbajtje dhe buzë për derdhjen e ujit.

15. Mekanizëm shtrydhës (rezervë) për kova larje. Të jetë material i fortë polipropilen ose ekuivalenti i tij dhe të pershtatet kovave të pastrimit me shtrydhëse objekt prokurimi (produkti me nr.13) duke u montuar dhe çmontuar lehtësisht.

16. Leckë për larje xhamash. Peceta të jetë me formë drejtkëndore, e përbërë nga fibra tekstili të buta që thithin ujin shumë mirë, me material mikrofibrë. Me përmasa 32cm x 32cm ± 1 cm, materiali të jetë i përbërë nga jo më pak se 80 ± 5 % poliestër dhe nga 20 ± 5 % poliamyde, me peshë specifike jo më pak se 200 g/m². Paketimi në plasmas ose karton në jo më shumë se dy copë për paketim.

17. Letër higjenike për WC e paketuar. Letër higjenike e përshtatshme për përdorim në tualet në formë ruloni me jo më pak se 185 shkëputje me përmasa Gjerësi 8-9 cm dhe Gjatësi 10-12 cm. Të jetë e përbërë nga celulozë e pastër me minimumi 3 shtresa dhe peshë specifike jo më pak se 15g/m². Paketimi në pako jo më pak se 10 rulona me plasmas ose karton. Standartet teknike që duhet të përmbushë, si vijon: Standartin Shqiptar SSH ISO 12625-5:2016 Letër pecetë dhe produkte letër pecetë - Pjesa 5: Përcaktimi i qëndrueshmërisë në tërheqje në gjendje të lagët, ose ekuivalentin e tij. Standartin Shqiptar SSH ISO 12625-8:2010 Letër pecetë dhe produkte letër pecetë - Pjesa 8: Koha e thithjes së ujit dhe kapaciteti i thithjes së ujit, ose ekuivalentin e tij.

18. Qese mbeturinash 35 litra: Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës min 35 litra dhe të përmbajë min 15 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. Të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse.

19. Qese mbeturinash 60 litra: Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës min 60 litra dhe të përmbajë min 15 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. Të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse.

20. Qese mbeturinash 100-120 litra: Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës min 100-120 litra dhe të përmbajë min 15 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. Të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse.

21. Shtupa për larje dyshemeje. Bazamenti i shtupës për montimin e bishtit të jetë prej polipropileni ose ekuivalenti i tij me fileto cilindrike ose konike, materiali i shtupës të jetë i përbërë nga jo më pak se 80 ± 10 % poliestër dhe nga 20 ± 5 % poliamyde, me peshë specifike jo më pak se 250 gr/m², gjatësia e fijes 35 ± 5 cm. Filetot e shtupës të përputhen me ato të bishtit të ofertuar. Pesha e produktit 200-300gr.

22. Sfungjer për pastrim hidrosanitairesh: Të jetë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjetë teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra. Përmasat; Gjatësia 150 ± 10 mm x Gjerësia 80 ± 10mm x Trashësia 35 ± 5 mm, me material sfungjër sintetik ku materiali i ashpërsuar të jetë me trashësi 5-7 mm. Materiali të jetë poroz që nuk lejon zhvillimin e baktereve, dhe të ketë jetëgjatësi. Paketimi në qese plastike ose karton me 2-6 copë dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

23. Solucion për larjen e dyshemeve: duhet të ketë këtë përbërje kimike: tensioaktivë anionikë deri në 5% dhe tensioaktivë jo-jonikë deri në 5%. Nga ana teknike, produkti duhet të përmbajë të paktën një përbërës konservues, të ketë përmbajtje të joneve [H⁺] me pH nga 7 deri në 10 dhe tretshmëri në ujë 100%. Biodegradimi parësor duhet të jetë jo më pak se 80%, ndërsa përmbajtja totale e lëndëve tensioaktive nuk duhet të jetë më shumë se 5%. Jetëgjatësia e produktit duhet të jetë jo më pak se 12 muaj nga koha e lëvrimit. Paketimi duhet të jetë në bidonë plastikë me kapacitet nga 1 deri në 5 litra, si dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

24. Solucion për larjen e xhamave: duhet të ketë këtë përbërje kimike: tensioaktivë anionikë deri në 5% dhe tensioaktivë jo-jonikë deri në 5%. Nga ana teknike, produkti duhet të përmbajë të paktën një lëndë konservuese, të ketë përmbajtje të joneve [H⁺] me pH nga 8 deri në 11, si dhe të sigurojë biodegradim parësor jo më pak se 80%. Përmbajtja e alkoolit izopropilik nuk duhet të jetë më shumë se 1%, ndërsa përmbajtja totale e lëndëve tensioaktive nuk duhet të jetë më shumë se 5%. Jetëgjatësia e produktit duhet

të jetë jo më pak se 12 muaj nga momenti i lëvrimit. Paketimi duhet të jetë në bidon plastik me kapacitet 750 ml, i pajisur me mekanizëm sprucimi.

25. Letër për fshirjen e duarve për kasetë tualeti. Letër higjenike duarsh për përdorim profesional me palosje z/v fold. Të jetë e përbërë nga celulozë e pastër 100% me minimumi 2 shtresa dhe peshë specifike jo më pak se 17g/m². Gjerësia e paketimit 10.5 ± 0.5 cm. Gjatësia e paketimit 21.5 ± 0.5 cm. Paketimi në pako plastmasi ose kartoni me jo më pak se 250 fije. Ngjyrë e bardhë. Standartet teknike që duhet të përmbushë, si vijon: Standartin Shqiptar SSH ISO 12625-5:2016 Letër pecetë dhe produkte letër pecetë - Pjesa 5: Përcaktimi i qëndrueshmërisë në tërheqje në gjendje të lagët, ose ekuivalentin e tij Standartin Shqiptar SSH ISO 12625-8:2010 Letër pecetë dhe produkte letër pecetë - Pjesa 8: Koha e thithjes së ujit dhe kapaciteti i thithjes së ujit, ose ekuivalentin e tij.

26. Doreza njëpërdorimëshe. Produkti i kërkuar duhet të jetë dorezë ekzaminimi dhe mbrojtëse prej nitrili pa pudër, josterile, me ngjyrë të bardhë ose blu, e përshtatshme vetëm për përdorim njëpërdorimësh. Materiali përbërës duhet të jetë gomë nitril-butadien. Produkti duhet të ofrohet në madhësi të ndryshme, minimalisht nga S deri në XL, me gjatësi jo më të vogël se 240 mm, trashësi orientuese në pëllëmbë dhe manshetë rreth 0.07 mm ± 0.02 mm dhe në gishta rreth 0.10 mm ± 0.02 mm. Dorezat duhet të kenë rezistencë në tërheqje jo më të vogël se 6 N. Dorezat duhet të jenë në përputhje me standardet EN 374-1/-2/-4/-5 Doreza mbrojtëse kundër kimikateve dhe mikroorganizmave, EN 21420:2020 Doreza mbrojtëse - Kërkesa të përgjithshme dhe metoda prove ose ekuivalentet e tyre. Produkti duhet të ruhet në ambient të freskët dhe të thatë, i mbrojtur nga rrezet direkte të diellit. Afati i përdorimit duhet të jetë minimalisht 2 (dy) vjet nga data e lëvrimit. Paketimi duhet të jetë me 100 copë, me paketim që garanton ruajtjen, transportin dhe përdorimin normal të produktit.